# LIBËR PËR MËSUESIN/EN

## EDUKATË MUZIKORE 2

# PËRMBAJTJE

HYRJE ..... 5

PLANI VJETOR ..... 11

PLANI MËSIMOR: SHTATOR-TETOR; NËNTOR-DHJETOR ..... 16

PLANI MËSIMOR: JANAR-SHKURT-MARS ..... 25

PLANI MËSIMOR: PRILL-MAJI-QERSHOR ..... 33

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE ..... 36

REFERENCA ..... 106

## I. HYRJE

Fëmijët krijojnë kontaktet e para me muzikën që në moshë të hershme, përmes zërit të nënës, në rrethin familjar, pastaj edhe përmes edukimit në institucionet parashkollore. Fëmijët këndojnë dhe dëgjojnë muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat, tingujt apo zhurmat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. Këto përvoja do të përdoren për edukimin muzikor në klasën e katërt duke i konkretizuar përjetimet nga jeta e përditshme në lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj. Përmes aktiviteteve muzikore, fëmijët përjetojnë gëzim dhe hare, si dhe qetësi duke ndikuar në pasurimin emocional të tyre, duke i fisnikëruar ata dhe njëkohësisht duke zhvilluar dispozitat e ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën mund të ketë pre-dispozitë.
Lënda “Edukatë muzikore” për klasën e dytë, ka për qëllim që të nxitë nxënësit/et ta duan muzikën si veprimtari dhe që përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitetet muzikore në klasë të zhvillojnë më tutje prirjet muzikore (këndim, luajtje në instrumente ose reagim ndaj muzikës dhe krijim muzikor).
Mësimi në shkollë bëhet më tërheqës dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme artistike, në të cilat ata nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në këtë klasë është që nxënësit/et të nxiten të përjetojnë veprat artistike muzikore (këngë, pjesë instrumentale etj.) dhe të fillojnë të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë nga veprimtaritë apo shkathtësitë artistike (këndim, krijime pamore, ritmizim, lëvizje etj.). Këto aktivitete nxitin zhvillimin emocional, intelektin, imagjinatën, vëmendjen, interesimin për kreativitet etj.

## I. METODOLOGJIA DHE FORMAT E PUNËS PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E EDUKATËS MUZIKORE

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga mësimdhënësit në përputhje me kurrikulën. E rëndësishme është që mësimdhënësit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t`i nxitë dhe do t`i ndihmojë fëmijët për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre artistike. Te fëmijët e klasës së dytë, sikurse në klasën e parë, këngët fëminore dhe lojërat muzikore janë thelbësore në mësimin e muzikës.
**Këngët** mësohen sipas veshit (me imitim) dhe mund të fillon gradualisht paraqitja e notacionit grafik me të cilin identifikohen lartësitë dhe gjatësitë tingëllore. Tematika e këngëve dhe lojërave duhet të jetë në përshtatje me moshën dhe aftësitë e tyre performuese (ambitusi), vështirësia e tekstit, e ritmit dhe posaçërisht përmbajta tekstuale me karakter edukativ dhe didaktik. Këngët duhet të jenë të shkurtra, të thjeshta dhe kryesisht të zhanrit të muzikës për fëmijë, por edhe këngë popullore e artistike, të thjeshta dhe të përshtatshme që mund të përdoren në këtë klasë.
Përmbajtja tematike mund të korrespondojë me temat që trajtohen nga fushat tjera mësimore, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Është e nevojshme që përgjatë këndimit të aplikojnë qëndrimin drejt, të shqiptojnë saktë tekstin dhe të përdorin një intonacion sa më të saktë. Fëmijët inkurajohen të këndojnë vetëm, por edhe në grup, të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimin e zërave të shokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shkopinjtë, shuplakat ose instrumentet, të ndjekin ndryshimet e ritmit etj.

Për edukimin e ndjenjës ritmike të fëmijëve duhet t'u demonstrojmë në formë konkrete dukurinë e ritmit, se si përjetohet dhe me pastaj ta zbatojmë atë në praktikë, si ta zëmë, dukuritë nga natyra dhe mjedisi, p.sh: të rrahurit e orës tik-tak, imitimi i trenit, rënia e ziles, rrahja e çekanit, rrahja e pulsit të dorës, rrahja e kambanës, rrahja e daulles në një marsh etj. Ligjërimet ritmike shoqërohen me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, duke i shoqëruar me duartrokitje, me shkopinj etj. Është e këshillueshme që ushtrimet ritmike të bëhen krahas këngëve dhe lojërave fëmijërore.

Puna me instrumentet muzikore shton interesin për aktivitetet muzikore, si dhe ndihmon në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike. Në këtë mënyrë krijojmë modele të thjeshta ritmike; rrahje me pëllëmbë, me vegla, me goditje etj. Mund të krijojmë instrumente prej materialeve ricikluese, me të cilat pastaj i shoqërojmë këngët, ligjërimet, por luajmë edhe ritme e melodi. Në këtë pjesë inkuadrohet edhe të mësuarit për disa nga konceptet bazike muzikore (ritmi, takti, gjatësitë tingëllore, raportet ritëm-metër etj.) shoqëruar edhe me simbolet grafike e të shkrimit muzikor.

**Dëgjimi** është mënyra kryesore, nëpërmjet të cilës fëmija vihet në marrëdhënie me muzikën. Përmes dëgjimit, ata shprehin emocione që sjell muzika. Mësimdhënësi/ja duhet të kultivojë ndjenjën e të dëgjuarit të zërit të tij, të shoqërojë muzikën me lëvizje të përshtatshme (duke vallëzuar balet, vals, marsh etj.). Dëgjimi zhvillon njëkohësisht dhe aftësinë për komentimin e fragmenteve muzikore shkëputur nga vepra të kompozitorëve kosovarë, shqiptarë dhe botërorë duke shprehur emocionet me një fjalor të thjeshtë e të përshtatshëm. Mësimdhënësi/ja mund të përdorë metodën e krahasimit, ku krahasohet një valle e një krahine me një valle të një krahine tjetër, krahasimi i ngjyrës së zërave të shokëve, apo të kafshëve dhe instrumenteve muzikore, etj. Pjesët që duhet të dëgjojë kjo moshë janë të përzgjedhura me kujdes, të thjeshta në përmbajtje muzikore dhe nuk zgjasin 2-4 minuta.

Në aspektin e ndërlidhjes dhe të integrimit, muzika mund të jetë pjesë e çdo teme të realizuar në klasën e dytë nga fusha të ndryshme; p.sh. në matematikë, krahasimi i thyesave me ndarjen e njësisë për numërim (nota katërshe, gjysmë, tetëshe), dukuritë e ndryshme muzikore në shkencat e natyrës (si prodhohet zëri, si përçohet zëri etj.) dhe ushtrimet gjatë orëve të edukatës fizike (ecja, vrapi, aktivitetet e ndryshme) mund të shoqërohen me muzikë ritmike. Pra, në çdo temë apo njësi mund të inkuadrohet muzika, përmes dëgjimit ose këndimit për të bërë mësimin më tërheqës për fëmijët e kësaj moshe. Dëgjimi i muzikës është edhe mjet i mirë për çlodhje gjatë pushimeve të shkurtra në ndërrimin e orëve. Muzika e ëmbël dhe e qetë ndikon pozitivisht që të përgatiten për mësimin e radhës. Disa aktivitete rutinë mund të zhvillohen përmes këngëve të ndryshme ose shembujve adekuatë muzikorë për dëgjim. Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë e cila kërkon t'i japë njohuritë e duhura nxënësve, të nxitë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate nëse nxënësit/et janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënit.* Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit,* të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar,* disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit,* disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësimdhënësit, të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, në të kujtuarit, në të kuptuarit. Për të arritur sukses në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi/ja t'i zbatojë stilet e të

nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit/et, pikëmbështetjet për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërinë e stileve të të nxënit dhe përdorimin e metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbushin detyra të rëndësishme të mësimdhënies sepse:

- sigurojnë përfshirjen aktive;
- nxitin diskutim të hapur;
- nxitin nxënësit/et të krijojnë dhe të bëjnë pyetje;
- nxitin shprehjen e mendimeve të nxënësve;
- ruajnë motivimin e nxënësve për të mësuar;
- sigurojnë një mjedis ku respektohen mendimet;
- krijojnë mundësi reflektimi në atë që nxënësit/et vlerësojnë;
- shërbejnë si nxitje për ndryshim;
- krijojnë shpresë për përfshirjen e nxënësve në mendimin kritik;
- zhvillojnë mendimin kritik te nxënësit/et.

**Stilet e të nxënit** që **përdoren në lëndën "Edukatë muzikore", kuptimi dhe përdorimi**

***Stili i të nxënit pamor*** është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast, mësimi konkretizohet duke përdorur mjete mësimore si: *foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, DVD (ku kemi dy lloj stilesh pamore dhe dëgjimore) etj.* Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësimdhënësi/ja, ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të mbajtur mend apo për të kujtuar një personalitet, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore;
- vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

***Stili i të nxënit dëgjimor,*** është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anë të shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet incizimeve, bisedave, diskutimeve ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësimdhënësi/ja ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës apo një situate në kontekstin e temës mësimore;
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme;
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

***Stili i të nxënit kinestetik*, është** kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar* etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore;
- i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënit, nxënësit/et zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete muzikore në grup, performime muzikore dhe kërcimi në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, vëzhgime dhe analiza të veprave figurative, biseda dhe debate në lidhje me çështje të caktuara shkencore etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës/e të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

Tematikat dhe përmbajtjet mësimore janë të integruara në funksion të edukimit me muzikën dhe mësimit të muzikës. Realizimi i këtyre përmbajtjeve, përmes veprimtarive të ndryshme muzikore ndihmon në njohjen, edukimin dhe kultivimin e nxënësve me vlerat muzikore më të spikatura të kulturës kombëtare shqiptare, por edhe ato botërore. Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimit të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënit janë:

1) Mësimi i këngëve bën pjesë në tri stilet e të nxënit: në të nxënit pamor, dëgjimor, por edhe kinestetik, sepse këngët duhet:
   - të mësohen *(stili dëgjimor)*;
   - të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertori i sugjeruar për t'u mësuar *(stili pamor – ndjekja me sy e takteve qe jep mësimdhënësi/ja)*;
   - të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, *(stili kinestetik),* por edhe perkusionit;
   - të shoqërohet me lëvizje trupore *(stili kinestetik)*.
2) Në fushën e *lojës me instrumente muzikore,* mësimdhënësi/ja bashkëpunon dhe angazhon nxënësit/et në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet e perkusionit për *shoqërimin e këngëve* që këndojnë.
3) *Dëgjimi muzikor* është veprimtari që bën pjesë në stilin e të nxënit dëgjimor dhe kinestetik, sepse zhvillon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, por synon edhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës, përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.

Teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë: Brainstorming-u, Diagrami i Venit, Loja me role, kllaster etj.

## II. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES

**III.1 Në stilin e të nxënit pamor dhe dëgjimor** veçojmë teknikën e kllasterit. **Kllasteri**, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet "harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit/et të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore (p.sh.: tingujt dhe zhurmat).

**III.2 Rrjeti i diskutimit** është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit/et të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të përjetuar muzikën dhe zhvilluar aftësitë gjykuese për muzikën që dëgjon p.sh.: më pëlqen se... Bazuar në strukturën ERR, ajo mund të përdoret në fazën e të kuptuarit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, nxënësit/et ndahet në dy grupe ("Pro" dhe "Kundër") të cilët diskutojnë me njëri-tjetrin përreth 15-25 minuta, sipas temës.

**III.3 *Brainstorming-u*** është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor** dhe dëgjimor, duke iu përshtatur lëndës së edukatës muzikore, sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim me CD, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera. Qëllimi i përdorimit të *Brainstorming*-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. *Brainstorming*-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera e nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura.




| TIPARE DALLUESE | TË PËRBASHKËTAT | TIPARE DALLUESE |
|---|---|---|
| ○ ____________ | ○ ____________ | ○ ____________ |

**III.5 Diagrami i Venit** është teknikë që bën pjesë në **stilin pamor,** por edhe **dëgjimor** më anë të së cilit evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit/et zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

## IV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësi/ja përdor mjete didaktike, materiale dhe burime të ndryshme informacioni, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit/et/et të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, fragmente nga vepra muzikore të ndryshme kosovare, shqiptare dhe botërore duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Teksti shkollor dhe materiale burimore të ndryshme sigurojnë një qasje të përshtatshme për moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të mediave, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve/eve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Mjete si magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja përdoren për dëgjim të veprave apo këngëve, shikim të shfaqjeve etj.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si: teksti shkollor, internet etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

• *Mjetet audiovizive si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.

• *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, etj.

• *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësimdhënësit, fletoret e punës, kat-

alogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga mësimdhënësit si pjesë e planifikimit të lëndës së edukatës muzikore. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.

• *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

## IV. KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I SIMBOLEVE QË PËRNDJEKIN TEKSTIN E Nxënësit/et: EDUKATË MUZIKORE, KLASA II

### V.1. Muzikë do të thotë të:

- Këndosh
- Dëgjosh
- Krijosh
- Çmosh dhe vlerësosh
- Marrësh pjesë në koncerte

Këto eksperienca do t'ju ndihmojnë për të çmuar dhe vlerësuar muzikën përreth jush. Por më e rëndësishmja është që ju të kuptoni se rrugët për të krijuar në muzikë dhe për të kuptuar atë, janë të shumëllojshme. Muzika është një emocion që zhvillohet brenda jush dhe ju performoni me të.

| Simboli në tekstin e nxënësit/et | Kuptimi i simbolit si e gjejmë në tekst |
|---|---|
|  | Dëgjoj këngën/ ritualin/lojën muzikore/fragmente muzikore. |
|  | Vizatoj<br>Ngjyros |
|  | Këndoj |
|  | Kërcej |
|  | Luaj dhe krijoj |
|  | Ligjëroj |
|  | Ndjekim ritmin |

**PLANI VJETOR**
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**
**KLASA: II**

<table>
<tr><td rowspan="14">**Lënda: Edukatë muzikore**</td><td colspan="4">**NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE**</td><td rowspan="2">**Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallë**</td></tr>
<tr><td colspan="2">**GJYSMËVJETORI I**</td><td colspan="2">**GJYSMËVJETORI II**</td></tr>
<tr><td>**PERIUDHA (I)**</td><td>**PERIUDHA (II)**</td><td>**PERIUDHA (III)**</td><td>**PERIUDHA (IV)**</td><td rowspan="12">***I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv***<br>I.3.<br>I.9.<br>I.6.<br>***II. Kompetenca e të menduarit-Mendimtar kreativ***<br>II.3.<br>II.5.<br>II.7.<br>II.8.<br>***III. Kompetenca e të mësuarit-Nxënës të suksesshëm***<br>III.1.<br>III.2.<br>III.5.<br>***IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv***<br>IV.1.<br>IV.2.<br>IV.3.<br>IV.6.<br>***V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë***<br>V.2.<br>V.4.<br>***VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm***<br>VI.1<br>VI.2<br>VI.3<br>VI.5</td></tr>
<tr><td>**Shtator-tetor**<br>**(9 orë)**</td><td>**Nëntor-dhjetor**<br>**(8 orë)**</td><td>**Janar-shkurt-mars**<br>**(11 orë)**</td><td>**Prill-maj-qershor**<br>**(9 orë)**</td></tr>
<tr><td>Këngë (3 orë)</td><td>Këngë (3 orë)</td><td>Këngë (3 orë)</td><td>Këngë (3 orë)</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>Krijime/ plotësime (1 orë)</td><td>Krijime/ plotësime (1 orë)</td></tr>
<tr><td>Lojë muzikore/ rituale (1 orë)</td><td></td><td></td><td>Lojë muzikore (1 orë)</td></tr>
<tr><td>Elemente bazike të gjuhës artistike (2 orë)</td><td>Elemente bazike të gjuhës artistike (2 orë)</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Llojet e muzikës (1 orë)</td><td></td><td>Llojet e muzikës (2 orë)</td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Instrumentet muzikore (1 orë)</td><td>Instrumentet muzikore (2 orë)</td><td>Instrumentet muzikore (1 orë)</td></tr>
<tr><td>Krijues dhe performues (1 orë)</td><td>Krijues dhe performues (1 orë)</td><td>Krijues dhe performues (1 orë)</td><td>Krijues dhe performues (1 orë)</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>Profesione muzikore (1 orë)</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>Institucionet artistike (1 orë)</td></tr>
<tr><td>Planifikime për mësimdhënësin (1 orë)</td><td>Planifikime për mësimdhënësin (1 orë)</td><td>Planifikime për mësimdhënësin (2 orë)</td><td>Planifikime për mësimdhënësin (3 orë)</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Njësitë mësimore | 1.1 Himni i Kosovës<br>1.2 Luajmë me ritmin<br>1.3 Lloje muzikore<br>1.4 Dallëndyshja<br>1.5 Tingull i lartë - tingull i ulët<br>1.6 Gëzoj pavarësinë<br>1.7 Lojë muzikore<br>1.8 Dëgjoj muzikë<br>1.9 Pyet lepurushin<br>1.10 Instrumente popullore<br>1.11 Loja po fillon<br>1.12 Tingull i gjatë - tingull i shkurtër<br>1.13 Dëgjoj muzikë<br>1.14 Slita dhe zilet<br>1.15 Ngjyra e zërit<br>1.16 Dhuratë nënës<br>1.17 Kërcimi dhe muzika<br>1.18 Tempi<br>1.19 Ora<br>1.20 Muzika dhe filmi vizatimor<br>1.21 Ngjyrosim instrumentet<br>1.22 Gjuha e kafshëve<br>1.23 Dëgjoj muzikë<br>1.24 Instrumentet e perkusionit<br>1.25 Dua të gëzoj<br>1.26 Ëndrra<br>1.27 Institucionet artistike<br>1.28 Dëgjoj muzikë<br>1.29 Luajmë me ritmin<br>1.30 Plotësoj dhe kujtoj<br>1.31 Ndërtoj instrumente muzikore<br>1.32 Profesionet në muzikë<br>1.33 Xixëllonja |

**GJYSMËVJETORI** **I**
**PERIUDHA:** **(1-2)**
**MUAJT:** ***Shtator-Tetor/ Nëntor-Dhjetor***
**FUSHA E KURRIKULËS:** **ARTE**
**LËNDA MËSIMORE:** **EDUKATË MUZIKORE**
**KLASA:** **II**

**KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE**
**TEMA I.1: KËNGË, LOJËRA MUZIKORE DHE KRIJIME MUZIKORE**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**
I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
**III. Kompetenca e të mësuarit – Nxënës të suksesshëm**
III.5 Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv**
IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.
**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**
V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
I.1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)
I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).
I.1.5 Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.
I.1.6 Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

**TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**
I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin në mënyrë konstruktive**.**
**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**
**III. Kompetenca e të mësuarit – Nxënës të suksesshëm**
III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv**

IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.

**VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm:**

VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**2.1** Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

**TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.

**II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ**

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

**III. Kompetenca e të mësuarit – Nxënës i suksesshëm**

III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv**

IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

3.1. Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

**TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv**

IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

**TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTET MUZIKORE**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.

**III. Kompetenca e të mësuarit –Nxënës të suksesshëm**

III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit.

III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.

**V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë**

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

III.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

**PERIUDHA (I dhe II)**
**MUAJT: *SHTATOR – TETOR (9 orë)/NËNTOR – DHJETOR (8 orë)***

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Temat mësimore | Koha e mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Këngë**<br><br>**Lojëra muzikore** | **Nxënësi/ja:**<br>**Këndon** këngë e melodi të thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).<br>**Ritmizon** vargje e ritme të këngëve, ligjërime ritmike (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).<br>**Luajnë** lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj., (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë). | 1.1 Himni i Kosovës<br><br>1.4 Dallëndyshja<br><br>1.6 Gëzoj pavarësinë<br><br>1.7Lojë muzikore<br><br>1.9. Pyet lepurushin<br><br>1.11.Loja po fillon<br><br>1.14.Slita dhe zilet | 7 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br><br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Krijim muzikor** | Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike, individualisht dhe në grup.<br>Krijon ritme e melodi të reja të shkurtra (me zë ose me instrumente muzikore). | 1.2. Luajmë me ritmin | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi I qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Elementet bazike të gjuhës artistike** | **Dallon** tingujt muzikorë sipas gjatësitë, lartësisë, ngjyrës dhe intensitetit.<br>**Përdor** saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t'u shprehur në mënyre artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj.). | 1.5. Tingull i lartë - tingull i ulët<br><br>1.12.Tingull i gjatë - tingull i shkurtër<br><br>1.13. Ngjyra e zërit | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>**-** Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Lloje muzikore** | **Identifikon** ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë. | 1.13. Lloje muzikore | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Instrumente muzikore** | **Dallon** instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, te tunxhit, frymore me harqe etj.). | 1.10. Instrumente popullore | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Krijues dhe performues** | **Identifikon** ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë. | 1.8 **Dëgjoj muzikë**<br><br>1.13 Dëgjoj muzikë | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi I qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Instrumente muzikore** | **Dallon** instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, te tunxhit, frymore me harqe etj.). | 1.10 Instrumente popullore | | | | | |

**GJYSMËVJETORI II**
**PERIUDHA: (3)**
**MUAJT: JANAR-MARS**
**FUSHA E KURRIKULËS: ARTE**
**LËNDA MËSIMORE: EDUKATË MUZIKORE**
**KLASA: II**

**KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE**
**TEMA I.1: KËNGË DHE KRIJIME MUZIKORE**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
IV.6. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.
**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**
V.4. Shfaqje e empatisë për të tjerët.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
I.1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)
I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).
I.1.5 Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.
I.1.6 Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
**TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin në mënyrë konstruktive**.**

**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**
VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**2.1** Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

**TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
**I.3** Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike**.**
**I.9** Nisja e veprimeve konstruktive.
**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
**III.1** Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
**IV.1** Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**3.1** Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

**TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**
V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

**TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTET MUZIKORE**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**

III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit.

III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

III.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

**PERIUDHA (III)**
**MUAJT: JANAR- SHKURT-MARS**

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha e mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Këngë** | **Nxënësi/ja:**<br>**Këndon** këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).<br>**Ritmizon** vargje e ritme të këngëve, ligjërime ritmike (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë). | 1.16. Dhuratë nënës<br>1.19. Ora<br>1.22. Gjuha e kafshëve<br>1.25. Dua të gëzoj | 4 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi I qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Elementet bazike të gjuhës artistike** | **Dallon** tingujt muzikorë sipas gjatësitë, lartësisë, ngjyrës dhe intensitetit.<br>**Përdor** saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t'u shprehur në mënyrë artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj). | 1.18. Tempi | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>**-** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>**-** Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llojet e muzikës** | **Dallon** lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike për vallëzim, muzike për film (vizatimor), muzike për fëmije, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).<br>**Identifikon** muzikën e pëlqyer dhe shpjegojnë arsyet. | 1.17. Kërcimi dhe muzika<br>1.20. Muzika dhe filmi vizatimor | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Instrumentet muzikore** | **Dallon** instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.). | 1.21. Ngjyrosim instrumentet<br>1.24. Instrumentet e perkusionit | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Krijues dhe performues** | **Identifikon** ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë. | 1.23 Dëgjoj muzikë | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

**GJYSMËVJETORI** **II**
**PERIUDHA:** **(4)**
**MUAJT:** **PRILL - QERSHOR**
**FUSHA E KURRIKULËS:** **ARTE**
**LËNDA MËSIMORE:** **EDUKATË MUZIKORE**
**KLASA:** **II**

**KONCEPETI I: KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE**
**TEMA I.1: KËNGË, LOJËRA MUZIKORE DHE KRIJIME MUZIKORE**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.6 Respektimi i rregullave të komunikimit.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
I.9 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.
**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**
V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
I.1.1. Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)
I.1.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).
I.1.5. Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.
I.1. 6. Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

**TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin në mënyrë konstruktive**.**
**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.
**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm:**
VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**2.1** Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

**TEMA MËSIMORE: KRIJUES DHE PERFORMUES**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.
**II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ**
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**
III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
3.1. Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

**TEMA MËSIMORE: LLOJET E MUZIKËS**
**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**
I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.
**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv**
IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**
V.4 Shfaqje e empatisë për të tjerët.
**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**
3.1 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

**TEMA MËSIMORE: INSTRUMENTET MUZIKORE**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

**I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv**

I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.9 Nisja e veprimeve konstruktive.

**III. Kompetenca e të mësuarit - Nxënës të suksesshëm**

III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit.

III.2. Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.

**V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë**

V.4. Shfaqje e empatisë për të tjerët.

**Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:**

III.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

| PERIUDHA (IV)<br>MUAJT: PRILL, MAJ, QERSHOR | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha e mësimore (orë)** mësimore) | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| **Këngë** | **Nxënësi/ja:**<br>**Këndon** këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).<br>**Ritmizon** vargje e ritme të këngëve, ligjërime ritmike (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë). | 1.26 Ëndrra<br>1.33 Xixëllonja | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Krijim muzikor** | Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike, individualisht dhe në grup.<br>Krijon ritme e melodi të reja të shkurtra (me zë ose me instrumente muzikore). | 1.29 Luajmë me ritmin<br>1.28 Plotësoj dhe kujtoj | 2 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia<br><br>- Edukimi për media | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |
| **Krijues dhe performues** | **Identifikon** ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë përmes veprave muzikore që dëgjojnë. | 1.28 Dëgjoj muzikë | 1 orë | Bisedë<br><br>Diskutim<br><br>Lojë me role<br><br>Breinstorming<br><br>Diagrama e Venit<br><br>Punë në grupe<br><br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br><br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br><br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br><br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br><br>- Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br><br>CD<br><br>DVD |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Lloje muzikore** | Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike për vallëzim, muzike për film (vizatimor), muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Identifikon muzikën e pëlqyer dhe shpjegojnë arsyet | 1.27 Institucionet artistike<br>1.32 Profesionet në muzikë | 2 orë | Bisedë<br>Diskutim<br>Lojë me role<br>Breinstorming<br>Diagrama e Venit<br>Punë në grupe<br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br>CD<br>DVD |
| **Instrumentet muzikore** | **Krijon** instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre të vogla etj.).<br>**Dallon** instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumente të drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj. | 1.31 Ndërtoj instrumente muzikore | 1 orë | Bisedë<br>Diskutim<br>Lojë me role<br>Breinstorming<br>Diagrama e Venit<br>Punë në grupe<br>Punë individuale | Buletini i pjesëmarrjes<br>Portofoli i nxënësit/et<br>Vlerësim i ndërsjellë | Njeriu dhe natyra,<br>Gjuhë shqipe,<br>Edukatë figurative,<br>Edukatë muzikore,<br>Edukata fizike, sporte dhe shëndeti,<br>Shoqëria dhe mjedisi,<br>Gjuhë angleze,<br>Matematikë<br>Çështjet ndërkurrikulare<br>- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike<br>- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm<br>- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë<br>- Globalizimi dhe ndërvarësia | Teksti shkollor<br>Softuerë arsimorë,<br>CD<br>DVD |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngët</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi të thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 dhe maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).<br>Ritmizon vargje e ritme të këngëve, ligjërime ritmike (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF .1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar).<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Himni i Kosovës”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: Atdhe, Toka e të parëve, Simbole, Gjuha shqipe.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të përshkruajnë: *simbolet që i bëjnë të bëhen krenar*.
I diskutojnë ato me njëri-tjetrin.

I
O mëmëdhe i dashur,
Vend i trimnisë
Çerdhe e dashurisë
N'ty shqipet fluturojnë
Dhe yjet ndriçojnë
Vend i të parëve tanë.

II
Ti qofsh bekue
Për jetë e mot,
O nënë e jonë
Ne të dalim zot
O mëmëdhe i dashur
Vend i trimnisë
Çerdhe e dashurisë.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**

**Mësojmë të këndojmë** "Himnin e Kosovës", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e këndimit.

**Vendoset** për dëgjim kënga dhe bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutrale.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth atdheut të tyre Kosovës, dhe pse ata ndihen krenarë që janë kosovarë/shqiptarë.

**Vlerësimi**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**Detyrat dhe puna e pavarur**
Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.
Udhëzohen nxënësit/et për **ngjyrosjen** e komunës së tyre në hartë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Krijim muzikor</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike, individualisht dhe në grup.<br>Krijon ritme e melodi të reja të shkurtra (me zë ose me instrumente muzikore).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>V.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4. Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>I.1.1 Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>I.1.2 Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).<br>I.1.5 Lëviz dhe improvizon në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.<br>I.1. 6 Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Luajmë me ritmin</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, ligjërim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton rreth ritmeve dhe krijimeve të mësuara më parë;<br>- ndjek saktë ritmin e këngës;<br>- improvizon me ritmin me dy goditje, sipas modelit të dhënë;<br>- ligjëron ritmin vetëm dhe në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Matematika<br>Kuptimi dhe përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “numrit”.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një gjithëpërfshirëse, ku mësimdhënësi/ja iu kërkon nxënësve të këndojnë këngën në ritmin me dy goditje.<br>Aty ku ligjërohet 1-2; 1-2-3-4 e me radhë, kënga duhet shoqëruar me përplasjen e këmbëve.<br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Mësojmë të këndojmë këngën *"Ne numërojmë"*, duke u mbështetur në *stilin dëgjimor* dhe *pamor* të të nxënit.<br>Shpjegohet modeli i marrë nga baza muzikore dhe krijuar me të një model ritmik dhe melodik:<br><br>I<br>Një dy, një dy,<br>një dy tre.<br>F'mij' të vegjël<br>Jemi ne.<br>Etj...<br><br>Ata këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës-lojë në ritëm, veprim dhe intonacion.<br>Më pas, ftohen nxënësit/et të krijojnë një model ritmik me dy goditje duke iu sugjeruar simbolet e rrahjes me 1 dhe me 2 goditje.Pasi plotësojnë krijimin e tyre, e prezantojnë.<br>**Demonstrimi i rezultateve të arritura**<br>Nxënësit/et:<br>- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth punës dhe këndimit në grup me modelet muzikore të marra nga kënga *"Ne numërojmë"*;<br>- diskutojnë me shokët ritmin që krijohet nga ligjërimi dhe këndimi;<br>- shpjegojnë krijimin e vet duke e ligjëruar atë saktë ritmikisht. |
| **Vlerësimi i nxënësit/et**<br>Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:<br>N 2: kuptimin e rregullave të këngës-lojë;<br>N3: zbatimin rregullave të këngës-lojë njëkohësisht me këndimin;<br>N3: këndimin e këngës-lojë ritmikisht dhe melodikisht;<br>N4: krijimin e modeleve ritmike me dy goditje. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës-lojë) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (mbi numërimin dhe numrat, por edhe me goditjet ritmike në taktin 2/4). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Llojet e muzikës”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzikë për film (vizatimor), muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).<br>Identifikon muzikën e pëlqyer dhe shpjegojnë arsyet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I. 3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I. 9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3.1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Llojet muzikore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: kënga për fëmijë, vallja popullore, kënga popullore, përjetim, dëgjim muzikor, emocion.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon këngën për fëmijë dhe karakterin që ato kanë;<br>- përshkruan përjetimin e këngës për fëmijë sipas emocioneve që ajo i krijon;<br>- shpjegon karakteristikat e këngës për fëmijë: shpejtë, gëzueshme, hareshme, e qetë, duke veçuar atë që i pëlqen më shumë;<br>- respekton mendimin dhe gjykimet e të tjerëve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha Arte: Edukatë figurative<br>Përdorimi i koncepteve figurative (ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e personazheve të parapëlqyera nga këngë të ndryshme për fëmijë.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet Brainstorming (5') ku nxiten nxënësit/et të flasin rreth muzikës.<br>A është e bukur muzika?<br>Po **kënga për fëmijë?**<br>Po vallja popullore? Nëse po, pse? Nëse jo, pse? Ata diskutojnë me njëri-tjetrin.<br><br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Vazhdohet më tej diskutimi rreth temave të mëposhtme.<br>• Çdo lloj arti ka gjuhën e vet.<br>• Muzika shprehet nëpërmjet tingujve.<br>• Poezia shprehet nëpërmjet fjalëve.<br>• Piktura shprehet nëpërmjet vizatimit.<br>• Baleti shprehet nëpërmjet lëvizjeve.<br>• Teatri shprehet nëpërmjet fjalëve dhe lëvizjeve.<br><br>Vendosen për dëgjim fragmente të këngëve për fëmijë. Cila të pëlqen më shumë?<br>- Kjo fazë e mësimit vazhdohet duke diskutuar çfarë përjetojnë nxënësit/et nëpërmjet këngëve apo valleve, si janë ato: të qeta, të gëzueshme apo të hareshme.<br>- Nxiten nxënësit/et që pas çdo dëgjimi të vizatojnë përjetimin e tyre emocional dhe të bëjnë krahasimin midis pjesëve që dëgjojnë.<br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Nxënësit/et bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore dhe njohuritë e reja dhe i ndajnë ato me njëri-tjetrin.<br>Përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë. |
| **Vlerësimi i nxënësve**<br>Demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: identifikimin nëpërmjet dëgjimit ose këndimit të këngëve për fëmijë, valleve popullore, këngëve popullore si lloje të muzikës;<br>N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) emocionin që i jep kënga për fëmijë, vallja apo kënga popullore;<br>N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës së këngëve sipas emocioneve që u shkaktohen. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe të shprehen emocionet rreth asaj që dëgjojnë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Ligjërimet ritmike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Ritmizon vargje e ritme të këngëve, ligjërime ritmike (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).<br>Luajnë lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.<br>I.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>III.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.<br>IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF I.1.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).<br>I.1.5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.<br>I.1.6. Përmes lojës imagjinon e krijon melodi, ritme, shoqërime, lëvizje e vallëzime në mënyrë të lirshme, origjinale dhe kreative</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: “Dallëndyshja”–Rituale popullore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: ritual, ritëm, melodi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbaton gjatësitë ritmike të përdorura në ritualet popullore;<br>- zbaton saktë ritualet gjatë ligjërimit dhe interpretimit;<br>- improvizon veprimin skenik të ritualeve popullore nëpërmjet lëvizjeve trupore;<br>- shoqëron ritualet duke përdorur mjetet trupore;<br>- improvizon vetëm ose në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Njeriu dhe natyra<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi fenomenet e shiut, diellit, mbjelljeve dhe kafshët e shpendët.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke iu kërkuar atyre të ligjërojnë duke shoqëruar me veprime lëvizore apo me mjete trupore ritualet e mësuara në klasë të parë.

**Ndërtimi i njohurive të reja**
Mësojmë ritualin “Dallëndyshja”.

*Dallëndyshe faqekuqe,*
*Merr verore, çon në det,*
*Na jep drit’e bereqet.*
*(Përsërite disa herë.)*

**Demonstrohet** mësimi i ritualeve nga mësimdhënësi/ja.
- Shkruhet në dërrasë një model ritmik në përputhje me tekstin ku nxënësit/et fillojnë të ligjërojnë fillimisht ritualin “Dallëndyshja” dhe më pas e vazhdojnë këtë ligjërim duke e shoqëruar me shuplaka dhe duke theksuar më shumë rrokjen e parë të çdo fjale.
- Ata diskutojnë më pas lidhur me këtë shembullin dhe simbolin e përdorur për të identifikuar tingullin e *gjatë apo të shkurtër,* si dhe *goditjet që ata dëgjojnë*.
- Nxënësit/et provojnë individualisht (solo) duke i përsëritur ritualet e mësuara disa herë deri në përvetësimin e tyre.




**Demonstrimi i rezultateve të arritura**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth shoqërimit dhe interpretimit të ritualit popullor që mësuan;
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ritmit që përftohet nga shoqërimi i ritualeve popullore;
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth goditjeve që dëgjojnë në ritualin “Dallëndyshe”, duke shpjeguar ndryshimet nga njëri-tjetri;
- imitojnë veçmas ose në grup ritualin;
- respektojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi i nxënësit/et/es:**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: improvizimin e ritualeve nëpërmjet lëvizjeve trupore dhe veprimit skenik;
N3: zbatimin e gjatësitë ritmike të përdorur në ritualin popullor;
N3: zbatimin e saktë të modelit ritmik të dhënë;
N4: shoqërimin e ritualeve me mjetet trupore;
N4: improvizimin e ritualeve vetëm ose në grup.

**Detyrat dhe puna e pavarur**
Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** dhe ligjërimin e ritualeve popullore.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre mbi ritualet popullore që mësuan dhe ritmi që ata përdorin për të luajtur ato.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Elementet bazike muzikore<br>Tema: “Tingulli i lartë – i ulët”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon tingujt muzikorë sipas gjatësitë, lartësisë, ngjyrës dhe intensitetit.<br>Përdor saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t’u shprehur në mënyrë artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.<br>III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br>IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 2.1. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj.; dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Tingull i lartë – tingull i ulët</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tingull, i lartë, i ulët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- kupton karakteristikat e tingujve në këngët e mësuara;<br>- demonstron nëpërmjet këndimit lartësisë e tingullit muzikor;<br>- zbaton në shembuj e thjeshtë kuptimin e karakteristikës (lartësisë) së mësuar të tingullit;<br>- ndan përvojën e vet me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Çështjet ndërkurrikulare: Mjedisi<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme të tingujve në mjedisin përreth dhe muzikë.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:**
- Mësimi fillon me një demonstrim ku nxënësit/et identifikojnë karakteristikën e tingullit: *lartësia.*
- Më pas këndojnë tingujt e mësuar në një shembull/këngë të mësuar.

**Ndërtimi i njohurive të reja:**
Nxënësit/et ligjërojnë ritualet e sjella në tekstin e tyre dhe evidentojnë duke shpjeguar me fjalët e veta dy karakteristikën e tingullit: lartësia. Mësimdhënësi/ja nxit që ata të përshkruajnë këtë karakteristikë:
- Kur themi **lartësi** tingulli, si e perceptojmë atë? Shkruani simbolin sipas dëshirës suaj për lartësinë e tingullit.
- Mësimdhënësi/ja nxit që ata të plotësojnë shembullin e dhënë "Tring zilja" dhe të vendosin fjalën në vendet bosh.
- Ata diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimit personal.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale**
Krijimet e nxënësit/et/es ruhen në dosjen e tyre.

**Vlerësimi i nxënësit/et:**
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
N2: zbulimin e karakteristikës së tingullit - lartësia;
N3: imitimin e karakteristikës e tingullit;
N4: shpjegimin e karakteristikës së tingullit që ka plotësuar **për krijimin e vet;**
N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

### Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për përfundimin e krijimit duke i udhëzuar ata.

### Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (tingujt, burimin e tyre, zhurmat, mjedisin).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF. 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar).<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Gëzoj pavarësinë ”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “Atdhe”, “Skënderbeu”, Teuta, etj.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të flasin lidhur me atdheun e tyre, Kosovën. Sa e dashur është ajo për ta? Si do ta nderojnë Kosovën duke u bërë sa më të aftë dhe të denjë? I diskutojnë mendimet e tyre me njëri-tjetrin.

I
Linda në trazira,
kurr' asgjë nuk dita.
Gëzoj pavar'sinë,
un' tani u rrita..

II
Festo tash lirin',
festo moj Kosovë,
festo shqiptarin',
bashkë jemi gjithmonë.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Mësojmë të këndojmë këngën "Gëzoj pavarësinë ", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e lojës dhe këndimit.
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për te mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

**Vlerësimi**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: interpretimin e këngës, me ndjenjë dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**Detyrat dhe puna e pavarur**
Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngët</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema te ndryshme por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.).<br>Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>III.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës-lojë.<br>IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>IV.6 Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF I.1.2. Ritmizon vargje, ritme (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë).<br>RNF I.1.5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.<br>RNF I.1.6. Përmes lojës imagjinon e krijon melodi, ritme, shoqërime, lëvizje e vallëzime në mënyrë të lirshme, origjinale dhe kreative.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Lojë muzikore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: krijim, theks, rrokje 2-3-4.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton rreth këngëve-lojë të mësuara më parë;<br>- zbaton ritmin e dhënë në formën e lojës;<br>- shpjegon krijimin muzikor;<br>- respekton punimin e vet dhe të shokëve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet një bisede / konkurs ku ftohen nxënësit/et të sjellin nga dy fjalë me 2-3-4 rrokje.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Vazhdohet me ushtrimin për kuptimin e gjatësisë ritmike në formë loje.

- Ligjëro rrokjet e fjalëve. Në cilën rrokje bie theksi?




**Vazhdohet** me ushtrimin tjetër ku nxënësit/et duhet të plotësojnë ushtrimin me fjalët dy-, tri- dhe katërrokëshe.




**Demonstrimi i rezultateve të arritura**
Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth fjalëve me 2-3-4 rrokje dhe ushtrimet që ata kanë plotësuar;
- prezantojnë punimin e vet duke respektuar njëri-tjetrin.

**Vlerësimi i nxënësit/et:**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: kuptimin e plotësimit të ushtrimeve të kërkuara;
N3: zbatimin e fjalëve me 2-3-4 rrokje;
N4: shpjegimin e punimit të vet lidhur me gjatësinë dhe theksin e fjalëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Udhëzohen nxënësit/et për krijimin e një ushtrimi muzikor duke respektuar njohuritë e marra në klasë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (mbi ritmin, gjatësinë e fjalëve, theksin etj.).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Krijues dhe performues”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).<br>RNF 3. 3. Emërton disa (së paku 4 krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Dëgjoj vepra muzikore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, instrumenti muzikor piano.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme;<br>- dëgjon dhe përcakton llojin muzikor që luhet kënga apo pjesa muzikore;<br>- përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika;<br>- krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha Arte: Edukatë figurative<br>Përdorimi i koncepteve figurative (ngjyrat) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese ku mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.<br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>- Vazhdohet me vendosjen për dëgjim fragmenti muzikor "Për Elizën" duke i ftuar nxënësit/et të diskutojnë rreth emocioneve që ata ndjejnë nga dëgjimi i veprës muzikore.<br>- Më pas nxënësit/et ngjyrosin personazhin e veprës, Elizën ose e vizatojnë atë, duke shprehur përjetimin emocional.<br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Nxënësit/et bëjnë përforcimin e njohurive të marra, duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan. |
| **Vlerësimi i nxënësve:** |
| Demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: evidentimin e muzikës që i pëlqen më shumë;<br>N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit) të emocionit që i jep muzika;<br>N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehen emocionet rreth asaj që dëgjojnë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Nxënësi/ja Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Pyet lepurushi”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “Miqësia”, “Besnikëria,”, “i mirë”, “i keq”.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të tregojnë një ngjarje që u ka ndodhur në klasë, shkollë, apo mëhallë. Si e kanë ndihmuar ata shokun /shoqen në një moment të vështirë? I diskutojnë mendimet me njëri-tjetrin.
**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Mësojmë të këndojmë këngën "Pyet Lepurushi", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e këndimit.
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

I
Lepurushi në dritare,
është i trembur,
s'ka gjum' fare.
Dhelpra qesh
e ngacmon,
Ujku dhëmbët
i tregon.

II
Dhelpra mbyll
njërin sy,
Ujku sytë i mbyll
të dy.
Por arushi
babaxhan
i afrohet aty pranë.

III
Mos ki frikë
ti lepurush!
Luajmë bashkë,
s'të prek kush.
Ç'u bë dhelpra,
ç'u bë ujku?
Pyet veten lepurushi.

**Vlerësimi i nxënësve:**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: e këngës, me ndjenje dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

### Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

### Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)

Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Edukatë muzikore** | **Shkalla e kurrikulës: I** | **Klasa: II** |
| **Konceptet:** Muzika dhe shoqëria<br>**Tema:** " Instrumentet muzikore" | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>**Dallon** ngjyrën tingëllore të instrumenteve kryesore muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre.<br>**Dallon** instrumentet në pamje krahas lodrave. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.). | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** "Instrumentet popullore" | | | |
| **Fjalët kyçe**: *qypi, çiftelia, fyelli, daullja, gajdja, lahuta.* | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>- Kupton rolin e instrumenteve popullore në shoqërimin e muzikës;<br>- shpjegon materialin, tingëllimin e instrumentit popullor dhe mënyrën e përdorimit;<br>- ngjyros instrumentet popullore;<br>- përshkruan punimin e vet dhe të shokut. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Edukata muzikore, klasa 2. | | | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Fusha: TIK<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi materialet e riciklueshme. | | | |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

  

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* (5 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet **diskutimit**, ku mësuesi kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për atë instrument që njohin më mirë.

***Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)***

- Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të ngjyrosin instrumentet popullore.
- Më pas bëhet njohja me instrumentet popullore duke i përdorur dhe treguar konkretisht ato, që nxënësit/et të kuptojnë:
  - *përbërjen,*
  - *mënyrën e përdorimit dhe*
  - *tingëllimit të tyre.*
- Nxënësit/et njëri pas tjetrit ose në grup provojnë të kuptojnë tri elementet për të cilat po mësojnë instrumentet. Ata provojnë dhe përgjigjen duke bashkëbiseduar me njëri-tjetrin.
- Nxiten nxënësit/et të të flasin rreth punës së tyre.

***Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur* (10 minuta)**

Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet popullore duke diskutuar me ata:

- Ku ndryshon pamja e instrumenteve popullore?
- Çfarë tingulli lëshojnë ato?
- Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra?

***Vlerësimi i nxënësve:***

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

N2: njohjen e instrumenteve popullore në shoqërimin e këngëve, melodive dhe valleve popullore;

N3: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit;

N4: ngjyrosjen e instrumenteve popullore.

### Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi.

### Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re për instrumentet popullore.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Loja po fillon”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “lojë”, “shok -shoqe”, “shkolla”, “mëhalla”.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth lojërave që ata zhvillojnë në familje, shkollë, qytet/krahinë. Cila prej tyre ka lënë mbresa te ta? Tregojnë lojën e tyre të preferuar? I diskutojnë mendimet me njëri-tjetrin.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**

Mësojmë të këndojmë këngën "Loja po fillon", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e këndimit.
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për te mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

I
Mësimet shum' i dua,
Pa to s'mund të rri
Por se një gjë tjetër
N'jet më sjell plot freski.
Ajo pra ësht' loja
Që më relakson
Mendjen edhe shpirtin
Mua më qetson.

Refreni
Loja është sport
Ajo t'bën të fort'
Të sjell shum' qet'si
Dhe plot dashuri.

**Vlerësimi**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**

Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda: Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Elementet bazike muzikore<br>Tema: “Elementet bazike të gjuhës artistike”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon tingujt muzikorë sipas gjatësitë, lartësisë, ngjyrës dhe intensitetit.<br>Përdor saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t’u shprehur në mënyre artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I. 7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.<br>III. 4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br>IV. 3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>VI. 5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Tingull i gjatë - shkurtër</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: gjatësia, tingull.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- kupton karakteristikat e tingujve në ritualet e mësuara;<br>- demonstron nëpërmjet ligjërimit dhe këndimit gjatësinë e tingullit muzikor;<br>- krijon shembuj të thjeshtë nëpërmjet karakteristikës së mësuar të tingullit;<br>- ndan përvojën e vet me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore<br>Çështjet ndërkurrikulare: Mjedisi<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme të tingujve në mjedisin përreth dhe muzikë.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:**
Mësimi fillon me një demonstrim ku nxënësit/et identifikojnë karakteristikën e tingullit: gjatësia. Më pas ligjërojnë gjatësinë e tingullit në një tekst kënge të mësuar më parë.

**Ndërtimi i njohurive të reja:**
Nxënësit/et evidentojnë duke shpjeguar me fjalët e veta dy karakteristikën e tingullit: gjatësia. Mësimdhënësi/ja nxit që ata të përshkruajnë këtë karakteristikë: Kur themi **gjatësi** tingulli, si e perceptojmë atë? Shkruani simbolin sipas dëshirës suaj për gjatësinë e tingullit.







Ata diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimit personal.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale**
Krijimet e nxënësit/et/es ruhen në dosjen e tyre.

**Vlerësimi i nxënësit/et:**
Demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
N2: zbulimin e karakteristikës së tingullit gjatësia;
N3: imitimin e karakteristikës së tingullit;
N4: shpjegimin e karakteristikës së tingullit që ka përdorur për krijimin e vet;
N4: zotërimin e të gjitha kërkesave muzikore të mësipërme.

### Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit/et për përfundimin e krijimit duke i udhëzuar ata.

### Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (tingujt, burimin e tyre, zhurmat, mjedisin).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Krijues dhe performues”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistike botërore dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).<br>RNF 3. 3. Emërton disa (së paku 4) krijues, interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Dëgjoj muzikë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, instrumente muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon nëpërmjet dëgjimit llojin e melodisë që dëgjon e trishtuar, e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme;<br>- dëgjon dhe kupton llojin muzikor që luhet këngë apo vepër muzikore;<br>- përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika;<br>- krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Muzika klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha Arte: Edukatë figurative<br>Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate **ndërvepruese** ku mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të flasin rreth muzikës apo një kompozitori që ata njohin më mirë.<br><br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Dëgjojmë **3 fragmente muzikore** dhe diskutojnë rreth karakterit me të cilën ato ekzekutohen. Nxënësit/et të shprehen lidhur me veprat muzikore, duke veçuar veprën që iu pëlqeu. Ata argumentojnë pëlqimet e tyre, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore.<br>Pjesët e vendosura nga kompozitorë kosovarë dhe shqiptarë.<br>• "Baresha", Kompozitori Rexho Mulliqi.<br>• "Kur bie fyelli , çiftelia", kompozitori Pjetër Gaci.<br>Më pas, ngjyrosin ose vizatojnë portretin e këngëtares së madhe, Nexhmije Pagarusha.<br><br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Nxënësit/et bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore nëpërmjet vizatimit dhe të shprehurit rreth asaj që ndjejnë për muzikën që dëgjuan. |
| **Vlerësimi**<br>Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:<br>N2: evidentimin e kompozitorit që i pëlqen më shumë nëpërmjet veprës muzikore;<br>N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që i jep muzika;<br>N4: krahasimin dhe diskutimin në ndryshimin e muzikës sipas emocioneve që i shkaktohen. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe të shprehin emocionet rreth asaj që dëgjojnë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Slita dhe zilet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve: “Krishtlindje”, “Vit i Ri,”, “Bajram”, festa, dhurata.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth festave që ata festojnë në familje, shkollë, qytet/krahinë. Cila prej tyre ka lënë mbresa te ta? Po kur vjen Viti i Ri, pse ata gëzojnë aq shumë? I diskutojnë mendimet me njëri-tjetrin.
**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Mësojmë të këndojmë këngët “Erdhi Viti i Ri” dhe “Slita dhe zilet”, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e këndimit.
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Kori
Zilet tring zilet tring
zilet tringëllojnë
o sa bukur kur rëshqet
mbi nje slitë me drerë
Hej!

I
Shkon kjo slita shkon
me gjithë atë shpejtësi
mbi dëborë shkel
sikur fluturon.
Me gaz e hare
zemrat na gëzojnë
Zilkat fort këmbojnë
dhe tringllimat lart jehojnë
Hej
Refreni

Zilet tring zilet tring
zilet tringëllojnë
o sa bukur kur rëshqet
mbi një slitë me drerë
Hej!

Përsëritet disa herë

**Vlerësimi**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**

Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Elementet bazike muzikore<br>Tema: “Elementet bazike të gjuhës artistike”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon tingujt muzikorë sipas gjatësitë, lartësisë, ngjyrës dhe intensitetit.<br>Përdor saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t’u shprehur në mënyrë artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.<br>III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br>IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 2.1. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj.; dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Ngjyra e zërit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: ngjyrimi i zërit të njeriut dhe ngjyrimi i tingullit të instrumenteve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- gjen tinguj të ndryshëm në mjedis që kanë ngjyrime të ndryshme të tingujve;<br>- imiton tingujt që dëgjon sipas karakteristikave që ata kanë;<br>- shpjegon dallimin e ngjyrimit të tingujve njerëzore dhe instrumenteve muzikore;<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Çështjet ndërkurrikulare: Mjedisi<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme të ngjyrimit të tingujve vokalë, mjedisore dhe muzikore.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme**<br>Mësimi fillon me identifikimin e karakteristikave të tingujve që dëgjohen në mjedisin përreth. Nxënësit/et flasin për ngjyrimin e asaj që dëgjojnë duke dhënë disa karakteristika *i butë, i ëmbël, i hollë, i fortë etj.*<br>**Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup dhe individuale**<br>- **Çdo objekt, instrument apo njeri ka një ngjyrim të caktuar.** U kërkohet nxënësve të imitojnë timbrin e zërave njerëzore apo objekteve të ndryshme ashtu si ata i imagjinojnë.<br>- Më pas vendosen disa foto nga përfaqësues të këngës, instrumente, objekte ose nga kafshë të ndryshme. Nxënësit/et nxiten të identifikojnë fotot dhe imitojnë duke luajtur timbrin/ngjyrimin e tingëllimit që ato lëshojnë i lartë ose i ulët, i trashë apo i hollë.<br><br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:**<br>Ata përfundojnë krijimin duke folur për ngjyrimin e zërit apo të instrumentit muzikor nën udhëheqjen e mësuesit/es. Punimet ruhen në dosjen e tyre. |
| **Vlerësimi i nxënësit/et**<br>Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: zbulimin e karakteristikave të ngjyrimit të zërit përmes dëgjimit ose në mjedisin përreth;<br>N3: identifikimin e karakteristikave të ngjyrimit të zërave apo tingujve gjatë dëgjimit;<br>N4; shpjegimin e karakteristikave të timbrit;<br>N4: ndarjen e përvojës së vet me të tjerët. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Krijimi i një liste me objekte, njerëz të veçantë dhe të njohur për klasën dhe instrumente muzikore që lëshojnë tinguj të ndryshëm, duke përcaktuar timbrin/ngjyrimin. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (ngjyrimin e zërit dhe instru-menteve). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi të thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Dhuratë nënës”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- këndon këngën në ritëm dhe intonacion;<br>- përjeton tekstin dhe muzikën e këngës, duke interpretuar me ndjenje dhe emocion;<br>- shpreh emocionet e veta për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi<br>Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve “nëna”, “familja”, “babai”, “8 marsi”.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, duke u kërkuar atyre të tregojnë rreth familjes së tyre. Nga sa persona përbëhet familja e tyre? Pse ata e duan shumë nënë e tyre? I diskutojnë mendimet me njëri-tjetrin.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Mësojmë të këndojmë këngën "Dhuratë nënës", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit. Kujtohet rregullat e këndimit.
Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja– me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.
- përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofa, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup, për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

I
O moj nëna ime e dashur,
ti më fal që po të zgjoj.
Se për festën e 8 Marsit,
sot kam ardhur të t'uroj.

II
O moj nëna ime e mirë,
a e sheh këtë shami?
Unë për ty e kam stolisur,
plot me mall e dashuri.

III
O moj nëna ime e dashur,
ti më fal që po të zgjoj.
Se për festën e 8 Marsit,
sot kam ardhur të t'uroj.

**Vlerësimi**
Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: këndimin e këngës me të tjerët;
N3: interpretimin e këngës, me ndjenje dhe emocion;
N4: shprehjen e emocioneve për këngën që këndon, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor;
N4: bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

**Detyrat dhe puna e pavarur**
Udhëzohen nxënësit/et për dëgjimin (disa herë të këngës), përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth interpretimit solo dhe në grup;
- shpjegojnë njëri-tjetrin dhe thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Llojet e muzikës”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike për vallëzim, muzike për film (vizatimor), muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).<br>Identifikon muzikën e pëlqyer dhe shpjegojnë arsyet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara)<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).<br>RNF 3. 3. Emërton disa (së paku 4 krijues) interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kërcimi dhe muzika</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përjetim, dëgjim muzikor, valle, balet, koreograf.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon lloje të kërcimi vallja dhe baleti;<br>- dëgjon dhe flet në lidhje me këto dy kërcime (valle popullore dhe balet);<br>- përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep kërcimi;<br>- krahason dhe përshkruan ndryshimin e valles popullore dhe baletit sipas emocioneve që i shkaktohen.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
**Fusha Arte:** Edukatë figurative
Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese ku mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të flasin lidhur me vallet popullore që ata pëlqejnë më shumë duke përmendur emrin e valles.

**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**
Shpjegojnë se çfarë janë vallja dhe baleti, duke vendosur ndonjë fragment nga të dyja llojet e kërcimit. Nxënësit/et dëgjojnë dhe diskutojnë rreth karakterit dhe mënyrës sesi ekzekutohet kërcimi.
Ftohen nxënësit/et të vallëzojnë vallen/vallëzimin e tyre të preferuar në klasë duke shfaqur aftësitë e tyre kërcyese.
Më pas, ata mund të vizatojnë sipas përjetimeve që ata ndjejnë dhe përshkruajnë me fjalët e veta emocionet.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**
Nxënësit/et:
- bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet e tyre ndaj kërcimeve të ndryshme.
- përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë.

**Vlerësimi i nxënësve:**
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
N2: identifikimin e llojeve kërcyese *valleve dhe baletit;*
N3: dëgjimin dhe përshkrimin në lidhje me këto dy kërcime (valle popullore dhe balet);
N3: përjetimin e emocioneve ndaj kërcimeve nëpërmjet arteve të tjera;
N4: krahasimin e ndryshimeve midis valles popullore dhe baletit.

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehin emocionet rreth asaj që dëgjojnë.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth kërcimit që dëgjojnë).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Elementet bazike muzikore<br>Tema: “Elementet bazike të gjuhës artistike”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Përdor saktë tingujt e ndryshëm muzikorë (sipas gjatësisë, lartësisë, ngjyrës, intensitetit) për t’u shprehur në mënyre artistike dhe për të krijuar efekte të ndryshme shprehëse artistike (dramaticitet, qetësi, nxitim, ngadalësim, forcë, etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.7 Dhënia dhe pranimi i informacionin muzikor për tingujt në mënyrë konstruktive.<br>III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.<br>IV.3 Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore.<br>VI.5 Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 2.1. Përmes perceptimit dhe përjetimit artistik njeh (vërejnë) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse, p.sh: përmes dëgjimit muzikor, vrojtimit të veprave artistike në tekste, katalogë, në ekspozita, në videoprezantime, në internet etj.; dhe në krijimet e veta vëren dhe dallon tingullin, vijat, ngjyrën, ritmin, melodinë, formën, dimensionin, raportin, kontrastin, teksturën etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Tempi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tempi, ngadalë, shpejt, mesatare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- demonstron kuptimin e funksionit/rolit të tempit në muzikë;<br>- zbaton ekzekutimin e tempit sipas udhëzimeve që merr nga mësimdhënësi;<br>- ekzekuton gjatë këndimit tempin muzikor.<br>- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve – (10 minuta)**

Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet një bisedës dhe një loje të vogël, ku nxënësit/et nxiten të gjejnë.

shkallën e shpejtësisë së lëvizjes për secilën kafshë të paraqitur në figurë (ngadalë, mesatare, shpejt).

Për shembull:




**Ndërtimi i njohurive të reja – (30 minuta)**

Shpjegohet ***tempi*** si koncept muzikor simbole apo shenja muzikore, të cilat shërbejnë për të ekzekutuar muzikën. Gjatë kompozimit, ai përcakton llojin e shpejtësisë së ritmit nëpërmjet disa simboleve muzikore. Këto simbole vendosen përgjatë partiturës dhe instrumentisti apo këngëtari i ekzekuton ato në shpejtësinë e duhur.

- Kërkohet që në ushtrimin e radhës nxënësit/et të punojnë individualisht, duke përcaktuar shkallën e shpejtësisë në simbolet muzikore që shikon në libër duke i plotësuar ato.
- Më pas, mësimdhënësi/ja vendos për dëgjim dy fragmente muzikore nga "Fluturimi i brumbullit" i Korsakov dhe "Karnavalet e kafshëve" e Sen Sans duke nxitur nxënësit/et të flasin rreth muzikës që dëgjojnë.
- Nxënësit/et diskutojnë plotësimin që ata kanë bërë me njëri tjetrin.

**Vlerësimi**

Vlerësimi do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:

N2: identifikimin e shenjave të ngjyrimit dhe tempit;

N3: ekzekutimin e këngëve dhe një melodie duke respektuar tempin dhe simbolet muzikore;

N4: shpjegimin e shenjave të ngjyrimit si dhe funksionimin e tyre në muzikë;

**Detyrat dhe puna e pavarur**

Udhëzohen nxënësit/et të krijojnë modele të tjera ritmike me katër goditje.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**

Mësimdhënësi/ja zhvillon një teknikë përmes diagramës së Venit, duke rikujtuar njohuritë e marra për tempin.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Ora”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: tekst i këngës, melodi, interpretim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton lidhur me tekstin e këngës;<br>- këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht;<br>- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;<br>- këndon vetëm dhe në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 32 CD, magnetofon.</td></tr>
</table>

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi/ja iu kërkon nxënësve të sjellin ndërmend ritmin me dy goditje dhe objektet që krijojnë këtë ritëm. Diskutohet me shokët e klasës.
M**ësojmë** këngën "Ora", duke vendosur për dëgjim në CD dhe mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja – me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

I
Nat' e dit' ora punon
Tike tak, tike tak,
Loja hiç nuk e huton,
Tike tike tak
Me çekan çekan të vet
Tike tike tak
Punën nuk e ndal aspak
Tike tike tak.

II
Një dëshir' ka mot e ka
Tike tak, tike tak,
Të vërtetën na e thot'
Tike tike tak.
30

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar
atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj.
Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

**Demonstrimi i rezultateve të arritura**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin mbi gjatësinë dhe lartësinë e tingujve të melodisë së këngës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
**Fusha:** Artet "Edukatë figurative"
Përdorimi i koncepteve të formës në vizatimin e formave të ndryshme që shikon në jetën e përditshme.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Vlerësimi**
Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- diskutimin me njëri-tjetrin lidhur me tekstin e këngës;
- këndimin e këngës saktë ritmikisht dhe melodikisht;
- këndimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- interpretimin e këngës vetëm dhe në grup.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
|---|
| Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re. |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Arte** | **Lënda: Edukatë muzikore** | **Shkalla e kurrikulës: I** | **Klasa: II** |
| **Konceptet:** Muzika dhe shoqëria<br>**Tema:** "Llojet e muzikës" | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>**Dallon** lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzike për film (vizatimor), muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.).<br>**Identifikon** muzikën e pëlqyer dhe shpjegojnë arsyet. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**<br>**RNF 3. 1.** Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.). | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Muzika dhe filmi vizatimor | | | |
| **Fjalët kyçe:** përjetim, dëgjim muzikor, muzikë e filmit për fëmijë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon nëpërmjet dëgjimit muzikën e filmit vizatimor të pëlqyer;<br>- dëgjon dhe përcakton muzikën e filmit vizatimor;<br>- përjeton nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika;<br>- krahason dhe përshkruan ndryshimin e muzikës së filmit vizatimor sipas emocioneve që i shkaktohen. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>**Fusha Arte:** Edukatë figurative<br>Përdorimi i koncepteve figurative (si ngjyrat, vija dhe forma) në realizimin e përjetimit muzikor nëpërmjet ngjyrosjes apo vizatimit. | | | |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: |
| --- |
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese ku mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të flasin lidhur me filmat vizatimore për fëmijë që ata pëlqejnë më shumë duke përmendur personazhet dhe përmbajtjen e filmit.<br><br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Dëgjohen disa fragmenteve muzikore të shkëputur nga filmat për fëmijë duke i ftuar ata të diskutojnë rreth muzikës që pëlqejnë. Nxënësit/et dëgjojnë dhe diskutojnë rreth karakterit dhe shpejtësisë me të cilën ekzekutohet muzika.<br>Pjesët e vendosura:<br>• *Muzika e filmit "Frouzen"*; nxënësit/et shprehen se ky fragment muzikor jep idenë e haresë, gëzimit, stinës së dimrit. Tingujt e muzikës përgjithësisht janë të gjatë.<br>• *Muzika e filmit "Pinoku"*; nxënësit/et shprehen se ky fragment muzikor jep idenë e haresë, gëzimit, lojërave.<br>• *Muzika e filmit "Mbreti Luan"*; nxënësit/et shprehen se ky fragment muzikor jep idenë e fuqisë dhe madhështisë.<br>Nxënësit/et vizatojnë sipas përjetimeve të tyre dhe përshkruajnë me fjalët e veta emocionet.<br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Nxënësit/et:<br>- bëjnë përforcimin e njohurive të marra duke diskutuar përjetimet muzikore të muzikës së filmit vizatimor për fëmijë;<br>- përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë. |
| **Vlerësimi i nxënësve:**<br>Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: identifikimin nëpërmjet dëgjimit muzikën e filmit vizatimor të pëlqyer;<br>N3: përcaktimin muzikën e filmit vizatimor;<br>N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera emocionin që i jep muzika;<br>N4: krahasimin dhe përshkrimin e ndryshimit të muzikës së filmit vizatimor sipas emocioneve që i shkaktohen. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehin emocionet rreth asaj që dëgjojnë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Instrumentet muzikore”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve kryesore muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre.<br>Dallon instrumentet në pamje krahas lodrave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Ngjyrosim instrumentet</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: violina, violonçeli, kitara, flauti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- kupton rolin e instrumenteve muzikore në shoqërimin e muzikës;<br>- shpjegon materialin, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit;<br>- ngjyros instrumentet muzikore;<br>- përshkruan punimin e vet dhe të shokut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit, ku mësimdhënësi/ja kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për atë instrument që njohin më mirë.<br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>- Bëhet njohja me instrumentet muzikore duke i përdorur dhe treguar konkretisht ato, që nxënësit/et të kuptojnë:<br>• përbërjen;<br>• mënyrën e përdorimit;<br>• tingëllimit të tyre.<br>Pastaj nxiten nxënësit/et të ngjyrosin dhe njëkohësisht të flasin rreth punës së tyre.<br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet në përgjithësi duke diskutuar me ata:<br>- Ku ndryshon pamja e instrumenteve muzikore?<br>- Çfarë tingulli lëshojnë ato?<br>- Ku ndryshojnë ato nga njëri-tjetri? |
| **Vlerësimi i nxënësve:**<br>Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: kuptimin e rolit të instrumenteve muzikore në shoqërimin e këngëve dhe melodive;<br>N3: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit.<br>N4: ngjyrosjen e instrumenteve muzikore. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re për instrumentet muzikore. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3 Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5 Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Gjuha e kafshëve”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton lidhur me tekstin e këngës;<br>- këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht;<br>- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;<br>- këndon vetëm dhe në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: Artet “Edukatë figurative” dhe Shkencat<br>Përdorimi i koncepteve të formës në vizatimin e formave të ndryshme që shikon në jetën e përditshme.<br>Lidhja e njohurive mbi shpendët dhe kafshët duke treguar rëndësinë për mbrojtjen e tyre.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit/et, ku mësimdhënësi/ja iu kërkon nxënësve të flasin rreth kujdesit që tregojnë ata për kafshët. Diskutohet me shokët e klasës.
**Mësojmë** këngën "Gjuha e kafshëve", duke vendosur për dëgjim në CD dhe mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

- dëgjimi i vijës melodike të këngës në CD.
- procedura metodike; ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi/ja dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga CD-ja – me vesh nga nxënësit/et.
- mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës/lojë në partiturë.
- këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- përvetësimi i këngës/lojë: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
- përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

I
Ciu-ciu-ciu, o zog i vogël!
Ciu-ciu, qan apo këndon!
Ciu-ciu, flas me nënën time,
Nëna gjuhën ma kupton.

II
Mjau-mjau-mjau, o ti moj mace!
Mjau-mjau, qan apo këndon!
Mjau-mjau, flas me nënën time,
Nëna gjuhën ma kupton.

III
Be-be-be, o ti moj dele!
Be-be, qan apo këndon!
Be-be, flas me nënën time,
Nëna gjuhën ma kupton.

Nxënësit/et mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj.
Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

**Demonstrimi i rezultateve të arritura**
Nxënësit/et:
- diskutojnë me njëri-tjetrin mbi gjatësinë dhe lartësinë e tingujve të melodisë së këngës.

**Vlerësimi**
Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
N2: diskutimin me njëri-tjetrin lidhur me tekstin e këngës;
N3: këndimin e këngës saktë ritmikisht dhe melodikisht;
N4: këndimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
N4: interpretimin e këngës vetëm dhe në grup.

**Detyrat dhe puna e pavarur**
Udhëzohen nxënësit/et për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Krijues dhe performues”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistik botërorë dhe lokale përmes veprave muzikore që dëgjojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>IV.1 Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që ka.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).<br>RNF 3. 3. Emërton disa (së paku 4 krijues) interpretues të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike globale e kombëtare.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Dëgjoj muzikë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përjetim emocional, dëgjim muzikor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon llojin e muzikës gjatë dëgjimit;<br>- përshkruan përjetimin e muzikës klasike sipas emocioneve që ajo i krijon;<br>- shpreh emocionet për muzikën që dëgjon përmes arteve të tjera si: vizatimi, lëvizjet trupore etj.;<br>- respekton mendimin dhe gjykimet e të tjerëve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2, CD, magnetofon.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha Arte: Edukatë figurative<br>Përdorimi i koncepteve figurative në realizimin e emocioneve.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve – Brainstorming (5 minuta)**<br>Ora mësimore nis nëpërmjet bisedës, duke i nxitur nxënësit/et të flasin rreth muzikës së tyre të parapëlqyer. Ata flasin dhe respektojnë me njëri-tjetrin gjatë diskutimeve.<br><br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Mësimdhënësi/ja u vendos dy vepra muzikore “Pranverën” nga Antonio Vivaldi dhe një fragment nga opera “Nabuko” e Verdit..<br>Nxënësit/et dëgjojnë fillimisht dy fragmentet dhe diskutojnë lidhur me muzikën.<br>▪ Fragment nga “ 4 Stin*ë*t”, A. Vivaldi.<br>▪ Fragment nga opera “Nabuko” Xh. Verdi.<br>Pas diskutimeve rreth dy veprave muzikore, përjetimin që u jep muzika e dëgjuar, nxënësit/et e zhvillojnë përmes arteve të tjera.<br>**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore (10 minuta)**<br>Përsëritin njohuritë e marra mbi emocionin dhe përjetimin në muzikë. |
| **Vlerësimi i nxënësve:**<br>Është demonstrimi i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: identifikimin llojit të muzikës që dëgjojnë (instrumenti i pianos dhe këndimi) nëpërmjet dëgjimit të llojit të muzikës, duke shpjeguar si është ajo *e shpejtë, e ëmbël, e gëzueshme, e fortë*;<br>N3: dëgjimin dhe përcaktimin e llojit të muzikës që dëgjon;<br>N3: përjetimin nëpërmjet arteve të tjera (vizatimit), emocionin që i jep muzika;<br>N4: krahasimin dhe diskutimin e ndryshimit të llojit të muzikës që dëgjon sipas emocioneve që i shkaktohen. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme dhe shprehin emocionet rreth asaj që dëgjojnë. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (përjetimin emocional rreth muzikës që dëgjojnë). |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Muzika dhe shoqëria<br>Tema: “Instrumentet muzikore”</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrumentet e drunjta, te tunxhit, frymore me harqe etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3 Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>I.9 Inicimi i veprimeve konstruktive.<br>III.1 Mësimi për të mësuar/nxënë; vetorganizimi i të nxënit.<br>III.2 Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit.<br>V.4 Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 3. 1. Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh. muzikën vokale, instrumentale, portretin, peizazhin etj.).</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Instrumentet perkusionit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: shkopinj, zile, trekëndësh, lodër, fyell.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- kupton rolin e instrumenteve të perkusionit në shoqërimin e muzikës;<br>- shpjegon materialin, tingëllimin e instrumentit të perkusionit dhe mënyrën e përdorimit;<br>- ngjyros instrumentet e perkusionit;<br>- përshkruan punimin e vet dhe të shokut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, klasa 2</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Fusha: TIK<br>Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi materialet e riciklueshme.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: |
|---|
| **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve (5 minuta)**<br>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet diskutimit, ku mësimdhënësi/ja kërkon të vëzhgojnë fotot në libër dhe flasin për instrumentin që njohin më mirë.<br>**Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta)**<br>Bëhet njohja me instrumentet popullore duke i përdorur dhe treguar konkretisht ato, që nxënësit/et të kuptojnë:<br>• përbërjen;<br>• mënyrën e përdorimit;<br>• tingëllimit të tyre.<br>Nxënësit/et njëri pas tjetrit ose në grup provojnë të kuptojnë tri elementet për të cilat po mësojnë instrumentet. Ata provojnë dhe përgjigjen duke bashkëbiseduar me njëri-tjetrin.<br>Pastaj nxiten nxënësit/et të ngjyrosin ose vizatojnë instrumentin e preferuar.<br>**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura (10 minuta)**<br>Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet popullore duke diskutuar me ata:<br>- Ku ndryshon pamja e instrumenteve popullore?<br>- Çfarë tingulli lëshojnë ato?<br>- Ku ndryshojnë ato nga njëra-tjetra? |
| **Vlerësimi i nxënësve:**<br>Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:<br>N2: kuptimin e rolit të instrumenteve të perkusionit **në shoqërimin e këngëve, melodive dhe Kërcimeve të ndryshme;**<br>N3: shpjegimin e materialit, tingëllimin e instrumentit dhe mënyrën e përdorimit;<br>N4: ngjyrosjen e instrumenteve të perkusionit. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur** |
| Udhëzohen nxënësit/et të vazhdojnë punimin e tyre në shtëpi. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re për instrumentet e perkusionit. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Arte</td><td>Lënda:<br>Edukatë muzikore</td><td>Shkalla e kurrikulës: I</td><td>Klasa: II</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike<br>Tema: Këngë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Këndon këngë e melodi te thjeshta (në grup) sipas imitimit, individualisht dhe në grup, së paku 5 e maksimum 10 këngë gjatë vitit shkollor. Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.<br>II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.<br>IV.5. Mësimi në grup dhe shkëmbimi i përvojave pozitive, gjatë këndimit dhe improvizimit të këngës.<br>V.4. Shfaqje e empatisë për bashkëmoshatarët.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>RNF 1. Këndon këngë e melodi të thjeshta sipas imitimit.<br>RNF. 5. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin, karakterin shprehës të muzikës etj.</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Këngë “Dua të gëzoj”</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton lidhur me tekstin e këngës;<br>- këndon këngën ritmikisht dhe melodikisht;<br>- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;<br>- këndon vetëm dhe në grup.</td></tr>
